

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara**SKK 14 TRAJTIMI KONTABËL I INVESTIMEVE NË PJESËMARRJE DHE SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA**

Pg.

STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 14 - TRAJTIMI KONTABËL I INVESTIMEVE NË PJESËMARRJE DHE SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA - I PËRMIRËSUAR

PËRMBAJTJA	Paragrafët
OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES	1-3
FUSHA E ZBATIMIT	4
PËRKUFIZIMET KRYESORE	5
INVESTIMET NË PJESËMARRJE	6-12
Pjesëmarrja	6-7
Matja – zgjedhja e politikës kontabël	8-11
Paraqitja e pasqyrave financiare	12
INVESTIMET NË SIPËRMARRJET E PËRBASHKËTA	13-26
Sipërmarrja e përbashkët	13-14
Aktivitetet e kontrolluara bashkërisht	15-16
Aktivitetet e kontrolluara bashkërisht	17-18
Njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht	19
Matja – zgjedhja e politikës kontabël	20-23
Transaksionet midis një sipërmarrësi dhe një sipërmarrjeje të përbashkët	24-25
Nëse investitori nuk ka kontroll të përbashkët	26
SHËNIMET SHPJEGUESE	27-31
Investimet në pjesëmarrje	27-29
Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta	30-31
DATA E HYRJES NË ZBATIM	32
KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (NVM)	33
BAZA E KONKLIZIONEVE	
UDHËZIM PËR ZBATIMIN E SKK 14	

OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES

- Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 14, “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta*” (‘SKK 14’ ose ‘Standardi’), nxjerrë dhe miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, si dhe shpallur nga Ministria e Financës, i ndryshuar, është të vendosë rregullat e kontabilizimit dhe, të paraqitjes së pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë. Këto standarde bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.
- SKK 14 mbështetet në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 27, “*Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale*”, SNK 7, “*Pasqyrat e fluksit monetar*”, SNK 28, “*Investime në pjesëmarrje*”, SNK 21, “*Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit*” dhe interpretimin SIC 12 *Konsolidimi, njësitë ekonomike për qëllime të veçanta*. SKK 14 është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 14 “*Investimet në pjesëmarrje*” dhe Seksionin 15 “*Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta*” të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Njësitë Ekonomike të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një krahasim i SKK-së me SNRF për NVM-të është dhënë në paragrafin 33. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 14 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare, dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.

3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky standard zbatohet për: a) trajtimin kontabël të pjesëmarrjeve në pasqyrat e konsoliduara financiare dhe në pasqyrat financiare të një investitori që nuk është një shoqëri mëmë, por që ka një investim në një ose më shumë pjesëmarrje. Paragrafët 6-12 përcakton kërkesat për trajtimin kontabël të pjesëmarrjeve në pasqyrat financiare të veçanta; b) për trajtimin kontabël të sipërmarrjeve të përbashkëta në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe në pasqyrat financiare të një investitori që nuk është një shoqëri mëmë, por që ka një interes sipërmarrës në një ose më shumë sipërmarrje të përbashkëta. Paragrafët 13-26 përcaktojnë kërkesat për trajtimin kontabël të interesit të një sipërmarrësi në një sipërmarrje të përbashkët në pasqyrat financiare të veçanta.
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
5	Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore, të përdorur në këtë standard: <u>Ndikimi i ndjeshëm</u> është aftësia për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve, në lidhje me politikat financiare dhe të shfrytëzimit të njësisë ku investohet, por jo kontrolli mbi këto vendime. <u>Pjesëmarrja</u> është njësi, mbi të cilën një investitor ka një influencë të ndjeshme, por që nuk është njësi e kontrolluar nga investitori. <u>Sipërmarrja e përbashkët</u> është një marrëveshje kontraktuale, ku dy ose më shumë palë marrin përsipër një aktivitet ekonomik, i cili është nën kontroll të përbashkët. <u>Njësia mëmë</u> është një njësi që zotëron një ose më shumë njësi të kontrolluara. <u>Interesi i pakicës</u> është pjesa e fitimit (humbjes) dhe e aktiveve neto të një njësie të kontrolluar, e cila u takon atyre pjesëve të kapitalit, të cilat nuk zotërohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (nëpërmjet njësite të kontrolluara) nga njësia mëmë. <u>Një biznes</u> është një tërësi veprimtarish të integruara, të kryera e të drejtuara me qëllim përfitimi që të arrihet: a) një kthim/fitim për investitorët; b) kosto më të ulëta ose përfitime të tjera ekonomike.
	INVESTIMET NË PJESEMARRJE
	Pjesëmarrja
6	Një pjesëmarrje është një njësi ekonomike, qoftë dhe e paorganizuar juridikisht si p.sh shoqëri e thjeshtë, mbi të cilën investitori ka ndikim të rëndësishëm, e cila nuk është as njësi e kontrolluar dhe as interes në një sipërmarrje të përbashkët.
7	Në përputhje me këtë Standard, pjesëmarrjet janë të gjitha ato njësi mbi të cilat investitori ka një ndikim të rëndësishëm në politikat e saj financiare dhe të shfrytëzimit, por nuk i kontrollon ato. Ndikimi i rëndësishëm presupozohet se ekziston kur investitori zotëron në mënyrë direkte ose të tërthortë, nëpërmjet shoqërive të kontrolluara, më shumë se 20% të së drejtës votuese të pjesëmarrjes, përveç rasteve përjashtimore kur mund të tregohet qartë se një zotërim i tillë nuk përbën ndikim të ndjeshëm. Ndikimi i ndjeshëm mund të ekzistojë, edhe nëse zotërohen më pak se 20%, kur një ndikimi i tillë mund të demonstron qartë. Një investitor nuk përjashtohet të ketë ndikim të ndjeshëm, edhe pse një investitor tjetër mund të ketë një pronësi të konsiderueshme ose shumicën. Ekzistenca e ndikimit të ndjeshëm karakterizohet nga faktorët e mëposhtëm: (a) përfaqësimi në drejtim ose në organin më të lartë të mbikëqyrjes; (b) pjesëmarrje në vendimet mbi hartimin e politikës së biznesit të njësisë ku është kryer investimi; (c) transaksione materiale mes njësisë që investon dhe njësisë ku është kryer investimi; (d) ndërshkëmbim i personelit drejtues, mes njësisë që investon dhe njësisë ku është kryer investimi; (e) shkëmbimi i informacionit teknik, mes njësisë që investon dhe njësisë ku është kryer investimi.
	Matja - zgjedhja e politikës kontabël
8	Një investitor do të trajtojë të gjitha investimet e tij në pjesëmarrje duke përdorur njërin prej modeleve në vijim: (a) sipas modelit të kapitalit në pasqyrat financiare të konsoliduara të investitorit (shih paragrafin 9); (b) sipas modelit të koston në pasqyrat financiare individuale të investitorit (shih paragrafët 10-11).
	Modeli i kapitalit
9	Sipas modelit të kapitalit, një investim në pjesëmarrje njihet fillimisht me çmimin e transaksionit (duke përfshirë kostot e transaksionit) dhe rregullohet më pas për të pasqyruar pjesën e investitorit në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes. (a) <i>Shpërndarjet dhe rregullimet e tjera në vlerën kontabël.</i> Shpërndarjet e marra nga investimi në pjesëmarrje ulin vlerën kontabël të investimit. Rregullimet në vlerën kontabël mund të jenë të nevojshme si pasojë e ndryshimeve në kapitalin e pjesëmarrjes si rezultat i zërave që prekin kapitalin (p.sh pagesa e dividendëve, rritja ose pakësimi i kapitalit themeltar, por duke përjashtuar riklasifikimet brenda kapitalit, si p.sh krijimi i rezervave ligjore). (b) <i>Të drejtat votuese të mundshme.</i> Edhe pse në përcaktimin nëse ekziston ose jo ndikim i ndjeshëm merren në konsideratë të drejtat votuese të mundshme, një investitor do të masë pjesën e tij në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes dhe pjesën e tij në ndryshimet në kapitalin e pjesëmarrjes mbi bazën e interesave të pronësisë aktuale. Në këtë matje nuk do të pasqyrohet ushtrimi ose konvertimi i

mundshëm i të drejtave votuese të mundshme.

(c) *Emri i mirë i nënkuptuar dhe rregullimet e vlerës së drejtë.* Menjëherë me kryerjen e investimit në një pjesëmarrje, një investitor do të kontabilizojë çdo diferencë (qoftë pozitive ose negative) midis koston së investimit dhe pjesës së investitorit në vlerat e drejta të aktiveve neto të identifikueshme të pjesëmarrjes në përputhje me SKK 9. Pas kryerjes së investimit, investitori do të rregullojë pjesën e tij në fitimet apo humbjet e pjesëmarrjes për amortizimin shtesë të aktiveve të amortizueshme të pjesëmarrjes (duke përfshirë edhe emrin e mirë) në bazë të tejkallimit të vlerave të tyre të drejta mbi vlerat kontabël të tyre në datën e kryerjes së investimit.

(d) *Zhvlërësimi.* Nëse ka tregues se një investim në një pjesëmarrje mund të jetë zhvlërësuar, një investitor do të testojë për zhvlërësim tërë vlerën kontabël të investimit, si një aktiv i vetëm, në përputhje me SKK 5. Çdo emër i mirë i përfshirë si pjesë e vlerës kontabël të investimit në pjesëmarrje nuk testohet veças për zhvlërësim por, si pjesë e testit për zhvlërësim të investimit si një i tërë.

(e) *Transaksionet e investitorit me pjesëmarrjet.* Në qoftë se një pjesëmarrje kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit, investitori do të eliminojë fitimet dhe humbjet e përealizuara që rezultojnë nga transaksionet nga poshtë-lartë (pra nga pjesëmarrja tek investitori) dhe nga lartë-poshtë (pra nga investitori tek pjesëmarrja) në masën e interesit të investitorit në pjesëmarrje. Humbjet e përealizuara për transaksione të tilla mund të evidentojnë një zhvlërësim të aktivitetit të transferuar.

(f) *Data e pasqyrave financiare të pjesëmarrjes.* Kur zbatohet modeli i kapitalit, investitori duhet të përdorë pasqyrat financiare të pjesëmarrjes të të njëjtës datë me atë të pasqyrave financiare të tij, me përjashtim kur kjo është e pamundur. Në qoftë se është e pamundur në gjë e tillë, investitori duhet të përdorë pasqyrat financiare më të fundit të pjesëmarrjes që ai ka të disponueshme, me rregullimet e bëra për efektet e çdo transaksioni të rëndësishëm apo ngjarjeve që ndodhin midis dy periudhave kontabël.

(g) *Politikat kontabël të pjesëmarrjes.* Nëse pjesëmarrja përdor politika kontabël, që ndryshojnë nga ato të investitorit, investitori do të rregullojë pasqyrat financiare të pjesëmarrjes për të pasqyruar politikat e tij kontabël me qëllim të zbatimit të modelit të kapitalit, përveçse kur një gjë e tillë është e pamundur.

(h) *Humbjet më të larta se investimi.* Nëse pjesa e humbjes e investitorit në një pjesëmarrje është e barabartë ose tejkalon shumë e investimit të tij në të, investitori do të ndërpresë njohjen e pjesës së tij në humbjet e ardhshme. Pasi interesi i investitorit është ulur në zero, investitori duhet të njohë humbje shtesë nëpërmjet një provizionit (shih SKK 6 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara*) vetëm në atë masë që investitori është përfshirë në detyrime ligjore ose konstruktive ose ka bërë pagesa në emër të pjesëmarrjes. Nëse pjesëmarrja më pas raporton fitime, investitori do të rifillojë të njohë pjesën e tij në këto fitime vetëm pasi kjo pjesë të jetë e barabartë me pjesën e humbjeve të panjohura.

(i) *Ndërprerja e modelit të kapitalit.* Një investitor do të pushojë së përdoruri metodën e kapitalit nga data që ka pushuar ndikimi i ndjeshëm.

(i) Në qoftë se pjesëmarrja bëhet një njësi e kontrolluar ose sipërmarrje e përbashkët, investitori do rrimasë interesin e kapitalit të tij mbajtur më parë me vlerën e drejtë dhe do të njohë fitimin ose humbjen neto që rezultojnë, në qoftë se ka, në fitim ose humbje.

(ii) Në qoftë se investitori humb ndikimin e ndjeshëm mbi një pjesëmarrje si rezultat i një shitje të plotë ose të pjesshme, ai do ta çregjistrojë pjesëmarrjen dhe do të njohë në fitim apo humbje diferencën midis, nga njëra anë, shumës së të ardhurave të marra plus vlerën e drejtë të çdo interesi të mbetur dhe, nga ana tjetër, vlerës kontabël të investimit në pjesëmarrje në datën që ka humbur ndikimi i ndjeshëm. Pas kësaj, investitori do të bëjë trajtimin kontabël për ndonjë interes të mbetur sipas SKK 3 *Instrumentet financiare*.

(iii) Në qoftë se investitori humb ndikimin e ndjeshëm për arsye të ndryshme nga shitja e pjesshme e investimit të tij, investitori do ta konsiderojë vlerën kontabël të investimit në këtë datë si një bazë për koston e re dhe do ta kontabilizojë investimin sipas SKK 3.

Modeli i koston

10 Një investitor duhet të masë investimet e tij në pjesëmarrje me kosto pakësuar me ndonjë humbje nga zhvlërësimi i akumuluar i njohur në përputhje me SKK 5 *Aktivitet afatgjatë materiale dhe aktivitet afatgjatë jomateriale*.

11 Investitori do të njohë dividendët dhe shpërndarjet e tjera të marra nga investimi si të ardhura pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e akumuluar të pjesëmarrjes para ose pas datës së blerjes.

Paraqitja e pasqyrave financiare

12 Një investitor duhet të klasifikojë investimet në pjesëmarrje si aktive afatgjatë.

INVESTIMET NË SIPËRMARRJET E PËRBASHKËTA

Sipërmarrja e përbashkët

13 Kontrolli i përbashkët është ndarja, sipas një marrëveshjeje kontraktuale, e kontrollit mbi një aktivitet ekonomik, dhe ekziston vetëm kur vendimet strategjike financiare dhe të shfrytëzimit që lidhen me aktivitetin kërkojnë pëlqimin unanimit të palëve që ndajnë kontrollin (sipërmarrësit).

14 Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje kontraktuale sipas të cilës dy apo më shumë palë ndërmarrin një veprimtari ekonomike që është subjekt i kontrollit të përbashkët. Sipërmarrjet e përbashkëta mund të marrin formën e aktiviteteve të kontrolluara së bashku, të aktiveve të kontrolluara së bashku, ose të njësisve të kontrolluara së bashku.

Aktivitetet e kontrolluara bashkërisht

15 Funksionimi i disa sipërmarrjeve të përbashkëta kërkon përdorimin e aktiveve dhe burimeve të tjera të sipërmarrësve dhe jo krijimin e një korporate, shoqërie të thjeshtë ose të një njësie ekonomike tjetër, apo të një strukture financiare që është e ndarë nga vetë sipërmarrësit. Çdo sipërmarrës përdor aktivitet afatgjatë materiale të veta, dhe inventarët e vet. Ai gjithashtu kryen shpenzimet e veta, ka

	detyrimet e veta dhe siguron financimet e tij, të cilat krijojnë detyrimet e tij. Aktivitetet e sipërmarrjes së përbashkët mund të kryhen nga punonjësit e sipërmarrësit përbri aktiviteteteve të ngjashme të sipërmarrësit. Marrëveshja e përbashkët e sipërmarrjes zakonisht përbën mjetin me anën e të cilit të ardhurat nga shitja e produktit të përbashkët dhe çdo shpenzim i bërë në mënyrë të përbashkët ndahen midis sipërmarrësve.
16	Në lidhje me interesat e tij në aktivitetet e kontrolluara bashkërisht, një sipërmarrës do të njohë në pasqyrat financiare të tij: (a) aktivet që ai kontrollon dhe detyrimet që i linden, dhe (b) shpenzimet që ai bën dhe pjesën e tij të të ardhurave që fiton nga shitja e mallrave ose shërbimeve nga sipërmarrja e përbashkët.
	Aktivitet e kontrolluara bashkërisht
17	Disa sipërmarrje të përbashkëta kërkojnë kontrollin e përbashkët, dhe shpesh pronësinë e përbashkët, nga sipërmarrësit të një ose më shumë aktiveve të kontribuara, ose të fituara për qëllim të sipërmarrjes së përbashkët dhe të dedikuar për qëllimet e sipërmarrjes së përbashkët.
18	Në lidhje me interesin e tij në një aktiv të kontrolluar bashkërisht, një sipërmarrës do të njohë në pasqyrat e tij financiare: (a) pjesën e tij në aktivet e kontrolluara bashkërisht, të klasifikuara sipas natyrës së tyre; (b) të gjitha detyrimet që ai ka krijuar; (c) pjesën e tij në çdo detyrim të krijuar së bashku me sipërmarrësit e tjerë në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët; (d) të ardhurat nga shitja ose përdorimi i pjesës së tij në prodhimin e sipërmarrjes së përbashkët, së bashku me pjesën e tij në çdo shpenzim të bërë nga sipërmarrja e përbashkët; dhe (e) shpenzimet që ai ka kryer në lidhje me interesin e tij në sipërmarrjen e përbashkët.
	Njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht
19	Një njësi ekonomike e kontrolluar bashkërisht është një sipërmarrje e përbashkët që përfshin krijimin e një korporate, shoqërie të thjeshtë ose të njësie ekonomike tjetër në të cilën çdo pjesëmarrës ka një interes. Njësia ekonomike vepron në të njëjtën mënyrë si njësitë ekonomike të tjera, përveç se një marrëveshje kontraktuale midis sipërmarrësve vendos kontroll të përbashkët mbi veprimtarinë ekonomike të njësisë.
	Matja – zgjedhja e politikës kontabël
20	Një investitor do të trajtojë të gjitha investimet e tij në sipërmarrjet e përbashkëta duke përdorur njerën prej modeleve në vijim: (a) sipas modelit të kapitalit në pasqyrat financiare të konsoliduara të investitorit (shih paragrafët 21); (b) sipas modelit të kostos në pasqyrat financiare individuale të investitorit (shih paragrafët 22-23).
	Modeli i kapitalit
21	Një sipërmarrës do të masë investimin e tij në njësinë ekonomike të kontrolluar bashkërisht me anën e modelit të kapitalit duke përdorur procedurat e dhëna në paragrafin 9 (duke zëvendësuar, aty ku përdoret, 'ndikim i ndjeshëm' me 'kontroll i përbashkët').
	Modeli i kostos
22	Një sipërmarrës do të masë investimet e tij në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht me kosto pakësuar me ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi i njohur në përputhje me SKK 5 <i>Aktivitet afatgjatë materiale dhe aktivitet afatgjatë jomateriale</i> .
23	Investitori do të njohë shpërndarjet e marra nga investimi si të ardhura, pa marrë parasysh nëse shpërndarjet janë nga fitimet e njësisë ekonomike të kontrolluar bashkërisht të akumuluar para ose pas datës së blerjes.
	Transaksionet midis një sipërmarrësi dhe një sipërmarrjeje të përbashkët
24	Kur një sipërmarrës jep kontribute ose i shet aktivet tek sipërmarrja e përbashkët, njohja e çdo pjese të fitimit ose humbjes nga transaksioni do të pasqyrojë përmbajtjen e transaksionit. Për aq kohë sa aktivet mbahen nga sipërmarrja e përbashkët, dhe sipërmarrësi i ka transferuar sipërmarrjes së përbashkët rreziqet dhe përfitimet më të rëndësishme të lidhura me pronësinë e aktiveve, sipërmarrësi do të njohë vetëm atë pjesë të fitimit ose humbjes që i atribuohet interesave të sipërmarrësve të tjerë. Sipërmarrësi do të njohë shumën e plotë të çdo humbjeje atëherë kur kontributi ose shitja evidenton një humbje nga zhvlerësimi.
25	Kur një sipërmarrës blen aktive nga një sipërmarrje e përbashkët, sipërmarrësi nuk do të njohë pjesën e tij në fitimet e sipërmarrjes së përbashkët nga transaksioni derisa ai (sipërmarrësi) t'ia rishesë aktivet një pale të pavarur. Një sipërmarrës do të njohë pjesën e tij në humbjet që rezultojnë nga këto transaksione në të njëjtën mënyrë si dhe fitimet, përveç se humbjet do të njihen menjëherë, atëherë kur ato përfaqësojnë një humbje nga zhvlerësimi.
	Nëse investitori nuk ka kontroll të përbashkët
26	Një investitor në një sipërmarrje të përbashkët që nuk ka kontroll të përbashkët do ta kontabilizojë investimin në përputhje me SKK 3 ose, nëse ai ka ndikim të ndjeshëm në sipërmarrjen e përbashkët, në përputhje me paragrafët 6-12 të këtij Standardi.
	SHËNIMET SHPJEGUESE
	Investimet në pjesëmarrje
27	Një investitor në një pjesëmarrje do të japë informacionet shpjeguese në vijim: (a) politikën e tij kontabël për investimet në pjesëmarrjet, (b) vlerën kontabël neto të investimeve në pjesëmarrje.
28	Për investimet në pjesëmarrje të kontabilizuara sipas modelit të kostos, një investitor do të japë informacion shpjegues për shumën e dividendëve dhe shpërndarjet e tjera të njohura si të ardhura.

29	Për investimet në pjesëmarrje të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit, një investitor do të japë informacion shpjegues veçmas për pjesën e vet në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjeve, dhe pjesën e tij në aktivitetet e ndërprera të pjesëmarrjeve, nëse ka të tilla.	
	Investimet në sipërmarrjet e përbashkëta	
30	Një investitor në një sipërmarrje të përbashkët do të japë informacion shpjegues për: <p>(a) politikën kontabël që ka përdorur për njohjen e interesave të tij në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht,</p> <p>(b) vlerën kontabël neto të investimeve në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht.</p> <p>(c) shumën totale të angazhimeve të tij në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta, duke përfshirë pjesën e tij në angazhimet e kapitalit që janë bërë së bashku me sipërmarrësit e tjerë, si edhe pjesën e tij të angazhimeve të kapitalit të vetë sipërmarrjeve të përbashkëta.</p>	
31	Për njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht, të kontabilizuara me modelin e kapitalit, sipërmarrësi duhet të japë gjithashtu informacione shpjeguese siç kërkohet nga paragrafi 30 për investimet me modelin e kapitalit.	
	DATA DHE RREGULLAT E HYRJES NË ZBATIM TË STANDARDEVE	
32	Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive.	
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME.	
33	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi meSNRF për NVM. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në standardin e referuar mund të kenë ndryshime.	
	Paragrafët sipas SKK 14	Paragrafët sipas SNRF për NVM botuar në korrik 2009
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 14.1, 15.1
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Sek 14.2
	Paragrafi 7	Sek 14.3
	Paragrafi 8	Sek 14.4
	Paragrafi 9	Sek 14.8
	Paragrafi 10	Sek 14.5
	Paragrafi 11	Sek 14.6
	Paragrafi 12	Sek 14.11
	Paragrafi 13	Sek 15.2
	Paragrafi 14	Sek 15.3
	Paragrafi 15	Sek 15.4
	Paragrafi 16	Sek 15.5
	Paragrafi 17	Sek 15.6
	Paragrafi 18	Sek 15.7
	Paragrafi 19	Sek 15.8
	Paragrafi 20	Sek 15.9
	Paragrafi 21	Sek 15.13
	Paragrafi 22	Sek 15.10
	Paragrafi 23	Sek 15.11
	Paragrafi 24	Sek 15.16
	Paragrafi 25	Sek 15.17
	Paragrafi 26	Sek 15.18
	Paragrafi 27	Asnjë
	Paragrafi 28	Asnjë
	Paragrafi 29	Asnjë
	Paragrafi 30	Sek 15.19
	Paragrafi 31	Sek 15.20
	Paragrafi 32	Asnjë